


Treguesit e HIV-it


Njohuritë

Përqindja e atyre që dinë dy mënyrat e parandalimit të HIV-it (duke pasur vetëm një partner seksual besnik të pa infektuar dhe përdorimi i rregullt i kondomit), që e dinë se një person që duket i shëndetshëm mund të jetë HIV pozitiv, dhe ata që i refuzojnë dy idetë e gabuara më të zakonshme



Stigmatizimi

Përqindja e atyre që raportojnë qëndrime diskriminuese ndaj personave që jetojnë me HIV, përfshirë :1) nuk do të blinin perime të freskëta nga një shitës ose tregtar që është HIV pozitiv dhe 2) mendojnë se fëmijët që jetojnë me HIV nuk duhet të lejohen të ndjekin shkollën me fëmijët që nuk kanë HIV




Mesazhet kryesore

- Vetëm 1 në 10 femra dhe meshkuj të moshës 15-24 vjeç në Kosovë kanë njohuri gjithëpërfshirëse në lidhje me parandalimin e HIV. Përqindja është e ngjashme për popullsinë e përgjithshme të femrave dhe meshkujve të moshës 15-49 vjeç.
- Përqindja e femrave dhe meshkujve të moshës 15-49 vjeç që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian me njohuri gjithëpërfshirëse në lidhje me parandalimin e HIV është e ulët (2 përqind). Megjithatë, në mesin e meshkujve të moshës 15-24 vjeç, njohuritë gjithëpërfshirëse rriten ndjeshëm me rritjen e pasurisë në ekonominë familjare (17 përqind e meshkujve të kësaj moshe që jetojnë në familje më të pasura kanë njohuri gjithëpërfshirëse, krahasuar me asnjë nga meshkujt që jetojnë në familjet më të varfëra).
- 8 në 10 gra dhe burra të moshës 15-49 vjeç në popullatën e përgjithshme dhe 9 në 10 gra dhe burra që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë shprehin qëndrime diskriminuese ndaj personave që jetojnë me HIV. Përqindjet janë po aq të larta në mesin e grave dhe burrave të moshës 15-24 vjeç.


Treguesit e HIV-it sipas karakteristikave kryesore

Njohuritë e vajzave adoleshente dhe femrave të reja (15–24 vjeç)*




*Përqindja e moshës 15–24 vjeç që dine dy mënyra të parandalimit të HIV-it, të cilët e dinë se një person që duket i shëndetshëm mund të jetë HIV pozitiv, dhe ata që i refuzojnë dy idetë e gabuara më të zakonshme.

Njohuritë e djemve adoleshentë dhe meshkujve të rinj (15–24 vjeç)*




Njohuritë e vajzave adoleshente dhe femrave të reja (15–24 vjeç)*



*Përqindja e moshës 15–24 vjeç që dine dy mënyra të parandalimit të HIV-it, të cilët e dinë se një person që duket i shëndetshëm mund të jetë HIV pozitiv, dhe ata që i refuzojnë dy idetë e gabuara më të zakonshme.
() Shifrat që bazohen në 25–49 raste të papeshuara

Njohuritë e djemve adoleshentë dhe meshkujve të rinj (15–24 vjeç)*



(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflektonte pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovën dhe mostrën për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në MICS për Kosovën, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e pasurisë të llogaritura, pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikun.

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovën (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë realizuar në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA)

UN Women. Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS e Kosovës 2019-2020 dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2019-2020 në Kosovë lidhur me HIV-in. Të dhënat nga kjo pasqyrë e shkurtër informative mund të gjenden në tabelat TM.11.1W, TM.11.1M, TM.11.3W, TM.11.3M, TM.11.6M në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë).

Pasqyrat tjera të shkurtra informative statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në mics.unicef.org/surveys.